



Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.8 dhe 5.13 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 dhe 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokoli 8648/24; dhe duke u bazuar në Raportin e Komisionit të Vlerësimit të datës 06.05.2025, të hartuar me Vendimin Nr. 17-BD/2025, për themelimin e Komisionit për blerje, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 24.06.2025, nxjerr këtë:

### VENDIM

1. **Miratohet Raporti i Komisionit të Vlerësimit** me numër protokoli 396/25 të datës 18.06.2025, për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme financiarisht për furnizimin e materialeve për inxhinierët e licencuar të OIRK-së.
2. **AMOS Creative** shpallet ofertuesi fitues për shkak të ofertës më të favorshme ekonomike dhe përbushjes së plotë të specifikimeve teknike.
3. Autorizohet Kryetari i OIRK-së që të procedojë me nënshkrimin e kontratës dhe realizimin e furnizimit me kompaninë **AMOS Creative**.
4. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së 
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 



## RAPORT PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTËS FINANCIARISHT MË TË FAVORSHME

**Lënda:** Furnizimi dhe personalizimi i materialeve për inxhinierët e licencuar

**Data e vlerësimit:** 17.06.2025

Pas shpalljes së Kërkesës për Ofertë për furnizimin dhe personalizimin e materialeve për inxhinierët e licencuar, janë kontaktuar disa kompani të ndryshme. Si rezultat, janë pranuar oferta nga pesë kompani si në vijim:

### Kompanitë pjesëmarrëse:

1. N.SH. 2B
2. StickerWave KS SH.P.K.
3. **AMOS Creative**
4. TIMEGATE
5. Trotek

### Objekt i kërkesës:

- Licenca (format A4, 300 gr, me ngjyrë, përmbajtje të personalizuar)
- Vula (dimensione 47x18 mm, përmbajtje e personalizuar për secilin inxhinier të licencuar)
- Kartela identifikimi (ID, dimensione 86x54 mm, personalizim dyfaqësh)
- Flamuj tavoline
- Vizitkarta

### Tabela përmbledhëse e çmimeve të ofruara (në euro):

Kompania	Licenca	Vula	Kartela ID	Flamuj Tavoline	Vizitkarta
N.SH. 2B	0.50	17.50	1.10	9.50	0.10
StickerWave KS	0.70	19.50	1.50	6.50	0.08
<b>AMOS Creative</b>	<b>0.45</b>	<b>16.80</b>	<b>1.00</b>	<b>5.50</b>	<b>0.065</b>
TIMEGATE	0.65	19.00	1.15	7.00	0.10



## ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kompania	Licenca	Vula	Kartela ID	Flamuj Tavoline	Vizitkarta
Trotek	1.00	17.50	0.50	-	-

### Vlerësimi dhe Rekomandimi:

Pas shqyrtimit të ofertave të pranuar, komisioni konstaton se:

- Kompania **AMOS Creative** ofron çmimin më të ulët për shumicën e produkteve të kërkuara (licenca, vula, kartela ID dhe vizitkarta).
- AMOS Creative është gjithashtu ofertuesi i vetëm që ka paraqitur një **ofertë të plotë për të gjitha produktet** e kërkuara, duke përbushur të gjitha specifikimet teknike.

Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët për furnizim të plotë dhe përbushje të specifikimeve teknike, komisioni vlerëson se **AMOS Creative** është ofertuesi më i favorshëm ekonomikisht dhe rekomandohet për realizimin e furnizimit.

Ky rekomandim i drejtohet **Bordit Drejtues të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për miratim**.

### Komisioni Vlerësues:

- **Arsim Rapuca**, Kryesues \_\_\_\_\_
- **Afrim Demiri**, Anëtar \_\_\_\_\_
- **Bujar Jupaj**, Anëtar \_\_\_\_\_



### Shënim:

Të gjitha ofertat e pranuar i bashkëngjiten këtij raporti si dokumentacion përcjellës.

Prishtinë, më 17.06.2025

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës